



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 286/2 Prot.

Tiranë, më 07.05.2020

V E N D I M

Nr.32, datë 07.05.2020

“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë të procedurës së lëvizjes paralele, për grupin e pozicioneve me kod #2555, me konkurrent nëpunësin **”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 220 prot., datë 21.02.2020, për disa pretendime të ngritura nga ankuesi *****, në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele, për grupin e pozicioneve me kod #2555, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Asteve dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse”, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a.

VËREJ SE:

Shtetasi ***** , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 220 prot., datë 21.02.2020, ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi nuk është plotësuar vlerësimi i fundit i punës në shërbimin civil, ç’ka e ka penguar atë për të marrë pjesë në procedurën e lëvizjes paralele, për grupin e pozicioneve me kod #2555, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Asteve dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse,

në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse”, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a.

Për verifikimin e pretendimeve të mësipërme, nëpërmjet shkresës nr. 220/1 prot., datë 05.03.2020, “Kërkim dokumentacioni për sqarimin e një kërkesë, protokolluar me nr. 220 prot., datë 21.02.2020”, është kërkuar nga institucioni (Ministria e Brendshme), informacion në lidhje me faktin nëse janë plotësuar ose jo vlerësimet e punës për nëpunësit civilë, e në veçanti për ankuesin *****, për periudhën Janar-Qershor 2018.

Nga ana e këtij institucioni, me shkresën nr. 220/3 prot., datë 04.05.2020, “Kthim përgjigje”, është vënë në dispozicion të Komisionerit akti që materializon procesin e ristrukturimit në Ministrinë e Brendshme, si edhe akti i liritimit nga shërbimi civil për nëpunësin *****, nga përmbajtja e të cilëve rezulton se ankuesi ka qenë i punësuar në Ministrinë e Brendshme, nga data 25.02.2014, deri në datën 08.06.2018, (kur është liruar nga shërbimi civil për arsye ristrukturimi), në pozicionin e punës “Kordinator, në Drejtorinë e Zhvillimit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Brendshme”, kategoria III-a.

Në praktikën e materialeve të dërguara nga institucioni, nuk evidentohet asnjë akt që të vërtetojë se është realizuar procesi i vlerësimit të pjesshëm të punës për punonjësit që janë liruar nga shërbimi civil, për arsye të riorganizimit të institucionit, për periudhën në fjalë.

Mos veprimin në këtë rast ministria e justifikon me faktin se institucioni në këtë periudhë ka qenë i përfshirë në dy procese ristrukturimi të njëpasnjëshme për shkak të ndryshimit strukturor, ç’ka e bënte të pamundur këtë veprim administrativ.

Të njëjtin argument i ka parashtruar edhe Departamenti të Administratës Publike institucioni, pas kërkesës së tij për të njohur situatën e vlerësimit të punës për ish punonjësin e Ministrisë së Brendshme, *****.

Në vijim të hetimit administrativ, ne drejtim të veprimeve të kryera në procesin e konkurrimit për grupin e pozicioneve në fjalë, nëpërmjet shkresës nr. 220/2 prot., datë 05.03.2020, Komisioneri ka kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike, të gjithë praktikën shkresore të publikuar në këtë rast. Me shkresën nr. 273 prot., datë 17.04.2020, “Kthim përgjigje”, është dërguar praktika e konkurrimit, në përmbajtje të së cilës edhe vendimi nr. 5, datë 18.02.2020 i DAP, “Për pezullimin e procedurës së lëvizjes paralele të shpallur me kodin #2555, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse”, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a, në përmbajtjen e të cilit argumentohen edhe arsyet e pezullimit të kësaj procedure konkurrimi.

Në këto rrethana, pasi u analizua dhe vlerësua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Ministria e Brendshme, Departamenti i Administratës Publike, si dhe dokumentacioni që shoqëron kërkesën e paraqitur, Komisioneri vlerëson se:

Në procedurën e lëvizjes paralele objekt ankimi, kanë rezultuar si kandidatë të interesuar për të marrë pjesë në konkurrim dy aplikantë, ndër të cilët, një kandidat i kualifikuar dhe ankuesi *****, i cili në fazën e verifikimit paraprak është skualifikuar me arsyen se nuk ka *ngarkuar vlerësimin e fundit për periudhën që ka qenë nëpunës civil*, ç'ka është një nga kushtet minimale që duhet të plotësojë nëpunësi për lëvizjen paralele. Ky qëndrim është mbajtur në kushtet kur kandidati ka qenë i punësuar pranë Ministrisë së Brendshme nga data 24.02.2014, deri në datën 08.06.2018, në pozicionin e punës “Koordinator, në Drejtorinë e Zhvillimit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Prokurimeve të Përqëndruara pranë Ministrisë së Brendshme”, në Ministrinë e Brendshme, ndërsa në dokumentet e aplikimit është ngarkuar formulari i vlerësimit të punës, për periudhën Janar-Qershor 2017.

Konstatohet se vendimi i DAP është marrë në mbështetje të nenit 26, pika 4, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Kreut II, pika 2, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, dispozita në të cilat kërkohet që për të marrë pjesë në procedurën e lëvizjes paralele kandidati duhet të plotësojë një prej kushteve minimale: “Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Duke vlerësuar se kandidati nuk plotëson njërin nga kushtet minimale për kualifikimin e tij në procedurën e lëvizjes paralele, përkatësisht vlerësimin e fundit të punës, DAP ka skualifikuar kandidatin ***** në procedurën e lëvizjes paralele në fjalë.

Rezulton se brenda afatit 3-ditor nga marrja e njoftimit për skualifikimin e tij, aplikanti ***** në datën 10.02.2020, ka paraqitur ankesë pranë njësisë përgjegjëse DAP, në lidhje me arsyen e skualifikimit, duke pretenduar se, vlerësimi i fundit që i është bërë nga eprorët në Ministrinë e Punëve të Brendshme është pikërisht ai i periudhës Janar-Korrik 2017, pavarësisht faktit që ai ka qenë i punësuar pranë këtij institucioni deri në datën 08.06.2018, pas të cilës ai ka dalë nga shërbimi civil.

Departamenti i Administratës Pubike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ka marrë në konsideratë ankesën e kandidatit ***** dhe për të sqaruar rrethanat e çështjes, me shkresën nr.1143 prot., datë 19.02.2020, i është drejtuar Ministrisë së Brendshme, ku ka kërkuar informacion dhe dokumentacionin e nevojshëm lidhur me vlerësimin e fundit të rezultateve në punë të ankuesit. Për këtë arsye, Departamenti i Administratës Pubike, me Vendimin nr. 5, datë 18.02.2020, “Për pezullimin e procedurës së lëvizjes paralele të shpallur me kodin #2555”, e ka pezulluar këtë procedurë konkurrimi.

Në vlerësim të rrethanave të parashtruara më sipër, Komisioneri vlerëson të drejtë veprimin e Departamentit të Administratës Pubike për të pezulluar procedurën e plotësimit të pozicionit të punës në fjalë, deri në momentin e plotësimit të detyrimit të Ministrisë së Brendshme, për të kryer vlerësimin e fundit të punës të ankuesit, që përkon me momentin e

lirimit të tij nga shërbimi civil, ashtu si parashikohet prej vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, konkretisht Kreu II, pika 2 e këtij akti.

Njësia e burimeve njerëzore në këtë institucion, duhet të kishte organizuar punën që Zyrtarët Raportues, të realizonin detyrën e tyre për të plotësuar formularët e vlerësimit të punës, për veprimtarinë e nëpunësve civilë, deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së tyre me shërbimin civil.

Mosveprimi i nëpunësve të ngarkuar nga ligji me procesin e vlerësimit të punës, në këtë rast ka sjellë si pasojë cënimin e të drejtës së nëpunësit civil *****, për të marrë pjesë në konkurrim. Njësia e burimeve njerëzore dhe zyrtarët përkatës nuk kanë plotësuar detyrimin që rrjedh prej nenit 62, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar. Në pikën 6, të vendimit të mësipërm, është parashikuar shprehimisht se si duhet të veprojnë nëpunësit vlerësues edhe në rastin kur largohen, apo ndodhen në pamundësi për të vijuar ushtrimin e detyrës:

“Në rast se gjatë periudhës së vlerësimit, zyrtarët që duhet të bëjnë vlerësimin largohen nga ai pozicion apo ndodhen në pamundësi të vazhdimin të mëtejshëm të detyrës, ata janë të detyruar të bëjnë vlerësimin për nëpunësin/nëpunësit për periudhën gjatë të cilës kanë ushtruar detyrën”.

Në rastin konkret jemi pikërisht, para rastit kur zyrtarët që duhet të bënin vlerësimin, për shkak të daljes së institucionit nga shërbimi civil, ndodhen në pamundësi ligjore për të shërbyer si pjesë e shërbimit civil, por detyrimi i tyre për të përmbyllur procesin e vlerësimit nuk ka përfunduar. Ata ishin të detyruar të plotësonin formularët e vlerësimit për aq kohë sa ka zgjatur marrëdhënia në shërbimin civil dhe moskryerja e kësaj detyre nuk mund të justifikohet me arsyetimin se nuk ishte mbushur afati 6-mujor.

Për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, njësia e burimeve njerëzore në Ministrinë e Brendshme dhe drejtuesi i institucionit të ristrukturuar, *Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara*, pavarësisht faktit se aktualisht, nuk është aktualisht pjesë e shërbimit civil, duhet të organizojnë punën për plotësimin e formularëve të vlerësimit, për gjithë nëpunësit civilë që kanë përfituar të drejta nga ristrukturimi i institucionit, përfshirë edhe ankuesin, që ka qenë i punësuar në pozicionin e punës “*Koordinator, në Drejtorinë e Zhvillimit të Prokurimeve*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Prokurimeve të Përqëndruara pranë Ministrisë së Brendshme, në mënyrë që të evitohen rastet e ngjashme me rastin në shqyrtim, kur shtetasit i mohohet padrejtësisht, mundësia për të përfituar nga e drejta që njihet pika 8, e nenit 50, të ligjit nr.152/2013, për të vijuar marrëdhënien në shërbimin civil.

Reaigimi duhet të jetë i menjëhershëm, pasi po pengohet Departamenti i Administratës Publike për plotësimin e pozicionit të punës në fjalë dhe nga ana tjetër, po pengohet ankuesi për të ushtruar të drejtën e tij për të marrë pjesë në konkurrimet për lëvizje paralele brenda një afati 2 vjeçar, i cili përfundon në datën 08.06.2020.

Në rastin konkret, nëse eprori i drejtpërdrejtë është larguar nga ai pozicion pune apo ndodhet në pamundësi të vazhdimit të mëtejshëm të detyrës, rast i parashikuar në pikën 6 të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar do të veprohet sipas pikës 8, të vendimit në fjalë dhe procesi i vlerësimit duhet të përfundojë nga zyrtari zëvendësues, në hierarkinë e pozicioneve të punës në Agjencinë e Blerjeve të Përqëndruara, ku kanë kaluar pas ristrukturimit, funksionet që kanë qenë në Drejtorinë e Përgjithshme të Prokurimeve të Përqëndruara, pranë Ministrisë së Brendshme, duke u bazuar në vlerësimet e mëparshme të nëpunësve civilë.

Për këto arsye:

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

VENDOSA:

1. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit Ministria e Brendshme, në respektim të procedurave të hollësishme të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, në bashkëpunim me titullarin e institucionit të varësisë, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, duhet të udhëheqë procesin për të përfunduar vlerësimin e pjesëshëm individual të punës për ankuesin ***** , për periudhën Janar-Qershor 2018, që kufizohet me momentin e ristrukturimit, si dhe të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësit civil që kanë qenë të punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Prokurimeve të Përqëndruara, pranë Ministrisë së Brendshme.
2. Me qëllim përmbushjen e detyrimeve në lidhje me institutin e vlerësimit të punës, për nëpunësit civil të institucionit të përfshirë në procesin e ristrukturimit, njësia e burimeve njerëzore në Ministrinë e Brendshme të njoftojë gjithë nëpunësit që përfitojnë nga ky veprim, duke i dërguar atyre aktin e vlerësimit, si dhe të informojë njësinë përgjegjëse, Departamentin e Administratës Publike për veprimet e kryera.

3. Në përfundim të procesit, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, siç parashikohet në pikën 18, të kreut II, të aktit nënligjor që rregullon vlerësimin e rezultateve në punë.
4. Të njoftohen të gjithë menaxherët në rolin e zyrtarit raportues/zyrtarit kundërfirmues/zyrtarit autorizues, me qëllim që të realizojnë detyrat që i ngarkon ligji dhe aktet nënligjore, të cilët do të mbajnë përgjegjësi personale në rast të mos zbatimit të detyrave të lëna në këtë vendim.
5. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, formularin e vlerësimit në fjalë.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **15** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
7. Me kalimin e këtij afati, njësia e burimeve njerëzore në Ministrinë e Brendëshme duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
8. Për këtë vendim të njoftohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Brendëshme, njësia e Burimeve njerëzore në Ministrinë e Brendëshme; Departamenti i Administratës Publike dhe titullari i Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara.
9. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha